



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.22/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e _____, i dyshuar për shkelje disiplinore, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat zoti Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore pala ankuese _____ dhe përfaqësuar nga _____ dhe përmbaruesi privat, _____ pas mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur me datën 30.12.2020, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, _____, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore _____ është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, _____, i shqiptohet masa disiplinore "vërejtje" e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.1. të LPP-së.

A r s y e t i m

Me datën 26.10.2020, pala ankuese, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, me të cilën ka kërkuar fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore. Pala ankuese pretendon se i njëjti ka kryer një vargë shkeljes disiplinore me rastin e ndërmartjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 1063/14. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi ka dërguar urdhërin për bllokimin e regjistrimit të automjeteve me të cilin ka bllokuar regjistrimin e pesë (5) veturave të cilat i përkasin debitorit, në kundërshtim me ligjin. Meqenëse përmbaruesi ka

dërguar urdhërin drejtpërdrejt në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve, pala ankuese pretendon se ata kanë humbur afatin e ankesës dhe rrjedhimisht vendimet e gjykatës kanë hudhur poshtë ankesat e tyre si të pasafatshme. Pala ankuese pretendon se sipas ligjit përmbaruesit nuk i njihet një e drejtë e tillë sepse veturat nuk kanë qenë të vendosura peng për sigurimin e kërkesës së kreditorit. Tutje pala ankuese thekson se bazuar në nenin 86 të LPP, "*përmbarimi për sendet e luajtshme zbatohet me anë të regjistrimit dhe vlerësimit të tyre, sekuestrimit, shitjes së sendeve dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve.*" Shton se ata kanë ofruar kreditorit marrëveshje për pagesë me këste pasi shuma e përgjithshme është e papërbalueshme dhe se përmbaruesi me veprimin e tij në kundërshtim me ligjin u ka shkaktuar dëme të konsiderueshme pasi nuk kanë pasur mundësi të funksionimit si biznes ngase veturat u kanë ngelur të paregjistruara.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që pasi urdhëri për përmbarim është bërë i formës së prerë dhe i përmbarueshëm në këtë çështje, ai - si organ përmbarues - ka filluar me procedurën përmbarimore sipas propozimit të kreditorit duke bllokuar llogaritë bankare. Meqenëse kjo ka rezultuar e pasuksesshme në realizimin e kërkesës, është vazhduar me realizimin e përmbarimit në sende të luajtshme të debitorit. Kjo është bërë në pajtim me ligjin. Tutje, përmbaruesi privat thekson që me qëllim të avansimit të metodave për realizimin e kërkesave të Kreditorëve, Oda e Përmbaruesve Privat në Kosovë ka arritur një numër Memorandumesh Bashkëpunimi me disa Institucione Shtetërore, ndër to edhe me Agjensionin për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilin është mundësuar qasje në të dhëna personale dhe të automjeteve, përfshirë identifikimin, bllokimin e regjistrimit dhe shitjen e automjeteve. Konform nenit 88 të LPP-së fillimisht bëhet identifikimi dhe inventarizimi elektronik i automjeteve si pasuri të luajtshme, pastaj konform nenin 82 të LPP, debitorit i pamunësohet disponimi me këto sende dhe mbi ato sende konsiderohet fitimi i së drejtës së pengut ligjor në pajtim me nenin 92 të KPP.

Me datën 30.12.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore; përfaqësuesi i palës ankuese sipas autorizimit si dhe përmbaruesit privat.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim se përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 të LPP, sepse i njëjti me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 1063/14, nuk i është përmbajtur ligjit, ka shkelur ligjin dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore.

Përfaqësuesi e palës ankuese ka bërë shtjellimin e ankesës duke theksuar se qëndron pranë pretendimeve të paraqitura me shkrim. Gjithashtu edhe përmbaruesi privat gjatë seancës ka paraqitur qëndrimin e tij se pretendimet e palës ankuese nuk janë të bazuar prandaj ka kërkuar nga Komisioni ta refuzoj atë.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP 782/19 dt 14.10.2019, Ankesën e Debitorit në Gjykatën e Apelit dt 28.10.2019; Memorandumin e Bashkëpunimit mes Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Odës së Përmbauesve Privat dt 02.03.2019; Procedurat Standarde të Operimit ARC dhe OPPK, dt 01.03.2019; Kërkesën për Pagesë me Këste përmes Postës Elektronike.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbauesi privat ka kryer veprë disiplinore.

Fillimisht, Komisioni gjen me rëndësi të thekson se sa i përket asaj nëse përmbauesi privat mund apo jo të bëjë bllokimin e regjistrimit të automjeteve të debitorit, kjo është çështje ligjore të cilën palët duhet adresuar në gjykata. Si të tilla, Komisioni nuk është i thirrur që të vlerësojë. Procedura disiplinore nuk është instancë tjetër gjyqësore ose zëvendësuese e organeve gjyqësore, ku palët mund të adresojnë kërkesat e tyre të natyrës juridike për të cilat kompetente është gjykata. Sidoqoftë, Komisioni gjen se bllokimi i regjistrimit të të gjitha automjeteve, me të cilin i pamundësohej funksionimi i gjithë veprimtarisë së debitorit ishte jo proporcional për realizimin e kërkesës. Pala ankuese kishte shprehur vullnetin që ta përmbush detyrimin e tij ndaj kreditorit përmes kësteve. Duke i bllokuar regjistrimin e të gjitha veturave, përmbauesi privat në rastin konkret i kishte vështirësuar debitorit përkatësisht palës ankuese në mënyrë të paarsyeshme përmbushen e detyrimit. Neni 9 i LPP, obligon organin përbarues që t'i kushtojë vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe që përmbarimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorit. Rrjedhimisht, Komisioni gjen se përmbauesi kishte vepruar në kundërshtim me ligjin.

Për sa i përket llojit dhe lartësisë së masës, Komisioni vlerësoi të gjitha rrethanat e rastit, përgjigjen e përmbauesit dhe pas analizës së tyre, gjen se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbauesit. Komisioni vlerëson se masa e shqiptuar është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbauesin si dhe tek përmbauesit tjerë që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 22/2020, datë 30.12.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ASUEI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

